

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 97/2023

PËR BUXHETIN E VITIT 2024

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

BUXHETI

Neni 1

Buxheti për vitin 2024 është:

Të ardhurat	676 098	milione lekë;
Shpenzimet	737 378	milione lekë;
Deficiti	61 280	milione lekë.

Buxheti përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2024 është:

Të ardhurat	489 359	milione lekë;
Shpenzimet	550 639	milione lekë;
Deficiti	61 280	milione lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2024 është:

Të ardhurat	71 249	milione lekë,
nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	24 343	milione lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	10 814	milione lekë;

- transferta sektoriale për pagat	1 500	milione lekë;
- të ardhura të tjera	34 592	milione lekë;
Shpenzimet	71 249	milione lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2024 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat gjithsej	169 838	milione lekë,
nga të cilat:		
- kontributet	133 059	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	36 779	milione lekë;
Shpenzimet	169 838	milione lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2024 teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar.

Të ardhurat gjithsej	8 200	milione lekë,
nga të cilat:		
- kontributet	3 180	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 020	milione lekë;
Shpenzimet	8 200	milione lekë.

3. Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 4 137 milionë lekë dhe bonusi i pensionistëve 3 650 milionë lekë. Ky fond ndahet midis skemave sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 3 700 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024.

Neni 5

1. Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2024 është:

Të ardhurat gjithsej	58 052	milione lekë,
nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	20 481	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	37 571	milione lekë;
Shpenzimet	58 052	milione lekë.

2. Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk e tejkalon tavanin prej 12 000 milionë lekësh. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve për vitin 2024 është:

Të ardhurat gjithsej	5 000	milionë lekë,
nga të cilat:		
- të ardhura të tjera	905	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 095	milionë lekë.
Shpenzimet	5 000	milionë lekë.

Neni 7

1. Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 7 000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja.

Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3 të përmendura në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.

2. Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4 të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji. Fondet që rishpërndahen me vendim të Këshillit të Ministrave nga programet sipas tabelës 1 të këtij ligji, si ato korrente dhe ato kapitale, në fondin e rindërtimit, nuk u nënshtrohen kufijve të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.

Neni 8

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	16 957	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	447 002	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	25 401	milionë lekë.

Neni 10

1. Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 50 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë dhe llogarive të fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë.

2. Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth (minus) 15 545 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë:

- Huamarrje afatgjatë e destinuar për projekte me vlerë rreth 30 030 milionë lekë;
- Huamarrje në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 6 571 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit me vlerë rreth 52 146 milionë lekë;
- Nënhua për pushtetin vendor me vlerë rreth 1 000 milionë lekë.

3. Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth 16 825 milionë lekë.

4. Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 10 000 milionë lekë.

5. Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

6. Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2024, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III

SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 11

1. Shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

- | | | |
|-------------------------------------|---------|---------------|
| - shpenzime të buxhetit qendror | 531 839 | milionë lekë; |
| - fondi rezervë i buxhetit | 2 500 | milionë lekë; |
| - kontingjenca për rritjen e pagave | 11 000 | milionë lekë; |
| - kontingjenca për risqet e borxhit | 5 300 | milionë lekë. |

2. Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale është sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 të këtij ligji përcaktohen kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2025 dhe 2026. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2024.

3. Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4 që i bashkëlidhet këtij ligji.

4. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit të fondeve që në muajin nëntor të vitit korrent nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitin 2025 dhe në vijim, me kushtin që kjo kontratë të bëhet efektive vetëm pas miratimit të ligjit të buxhetit përkatës. Për projektet e investimeve publike shumëvjeçare, me vlerë të plotë mbi 650 milionë lekë, procedura e prokurimit mund të fillojë që në muajin prill të vitit korrent.

5. Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit, të përcaktuara në shpenzimet korrente të programit buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Fondi prej 100 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përdoret për parafinancimin, bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj. Procedurat e shpërndarjes së këtij fondi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, si dhe në tabelat 1 dhe 3, që përmenden përkatësisht në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.

7. Fondi prej 400 milionë lekësh në zërin "shpenzime kapitale" në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes" të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e projekteve të infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes të bashkive.

Neni 12

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 85 274. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese ose krijimit të institucioneve të reja.

Numri i punonjësve, i cili nga ristrukturimi i çdo institucioni, i realizuar në kuadër të reformës së pagave, rezulton i pakësuar në krahasim me atë të miratuar në tabelën 2 të këtij ligji, kalon në numrin rezervë të parashikuar në këtë tabelë dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve/funksioneve të reja, si dhe për strukturat e lidhura me negociatat dhe anëtarësimin në Bashkimin European.

2. Këshilli i Ministrave përcakton numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Rregullat për kontraktimin dhe pagesën e punonjësve të përkohshëm përcaktohen në aneksin 5 që i bashkëlidhet këtij ligji.

3. Për vitin 2024 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve/funksioneve të reja. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përlogaritur sipas gradave të miratuara.

4. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 400 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13

Paga e Presidentit të Republikës është 425 000 lekë në muaj.

Neni 14

1. Fondi rezervë prej 2 500 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Çdo ministri apo institucion qendror buxhetor paraqet kërkesën për përdorimin e fondit rezervë në ministrinë përgjegjëse për financat, në

përputhje me kërkesat e nenit 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pas miratimit të kërkesës nga ministri përgjegjës për financat, ministria apo institucioni qendror buxhetor paraqet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin përkatës.

2. Kontingjenca për risqet e borxhit prej 5 300 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit me ndikim në shpenzimet për interesa.

3. Kontingjenca për rritjen e pagave prej 11 000 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për politika të reja pagash.

4. Shumat e shpërndara nga fondi rezervë, kontingjenca për risqet e borxhit dhe kontingjenca për rritjen e pagave shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 15

1. Transferta e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për programin buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara në bashkitë shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij ligji.

4. Personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 punonjës.

5. Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

6. Fondi për emergjencat civile në masën 800 milionë lekë akordohet në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive.

7. Fondi prej 1 000 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore, sipas kriterëve në aneksin 6, që i bashkëlidhet këtij ligji.

8. Fondi prej 500 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e projekteve që lidhen me digat, sipas kriterëve në aneksin 7, që i bashkëlidhet këtij ligji.

9. Fondi prej 200 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes përdoret për eliminimin e pasojave në rastet e fatkeqësive natyrore, kur shpenzimi ka natyrën e investimit. Ky fond shpërndahet gjatë vitit buxhetor në bazë të kërkesës së njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas rasteve të ndodhjes së fatkeqësisë.

10. Fondi për mbetjet urbane, në masën 788 milionë lekë akordohet si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbetjet urbane në kolonën “Menaxhimi i mbetjeve urbane” dhe përdoret/shpërndahet në përputhje me kriteret e vendosura në aneksin 8, që i bashkëlidhet këtij ligji.

11. Njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për financim/bashkëfinancim për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe asaj sportive pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sportin.

Ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin nxjerr udhëzim për kriteret, procedurat, afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 16

1. Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive të mëposhtme:

- a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) granti i mësimdhënies;
- c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

3. Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në nenet 111 dhe 113 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

4. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë mund të shpërndahet edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore në ato raste kur me vendim të Këshillit të Ministrave ato përcaktohen autoritete kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit për studim-projektimin apo zbatimin e projektit për një ose disa institucione të arsimit të lartë. Në këto raste çelja e fondit nga ministria përgjegjëse për financat bëhet pas paraqitjes së kërkesës nga njësia e vetëqeverisjes vendore përmes ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 17

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës I që përmendet në nenin 11 të këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Të drejtat e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore përcaktojnë treguesit e faktit në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 18

Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2023, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, është 30.6% e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.

Neni 19

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfutuese për vitin 2024, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 33 792 milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- a) për rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore deri në 34 455 milionë lekë;
- b) për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfutuese deri në (minus) 663 milionë lekë.

2. Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 454 516 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- a) stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 407 816 milionë lekë;
- b) stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 45 800 milionë lekë;
- c) stoku i borxhit të vetëqeverisjes vendore 900 milionë lekë.

Neni 20

1. Në rast të avancimit në kohë me emetimin përgjatë vitit buxhetor 2024 të një eurobondi të ri, i cili është parashikuar në vitin buxhetor 2025, në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe në rast të përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, kufijtë përkatës për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore dhe nivelin e vlerësuar të stokut total të borxhit publik, të përcaktuar në nenet 10 dhe 19 të këtij ligji, mund të tejkalohen deri në shumën e vlerave të përmendura më poshtë:

- a) vlera e eurobondit të emetuar në avancë;
- b) vlera e kredisë në formën e “mbështetjes buxhetore” të disbursuar;
- c) vlera e përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar.

2. Niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2024 mbetet i pandryshuar sipas përcaktimit në nenin 1 të këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe të mbartet për të financuar buxhetet e viteve buxhetore pasardhëse, por, në mbyllje të vitit buxhetor, gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për atë vit buxhetor.

Neni 21

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2024.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 7.12.2023